**3.** Lokalni Koordinacioni Mehanizam u navedenom sastavu kao u tački (2) dva ove Odluke, ima dužnosti i odgovornosti da identifikuje potrebe za pružanje podrške žrtvama nasilja u porodici, nasilja nad ženama, nasilje po rodnoj osnovi u skladu sa definicijama datim u Istanbulskoj konvenciji i važećeg zakona za sprečavanje i zaštitu nasilja u porodici, nasilja nad ženama i nasilja po rodnoj osnovi, Br. 08/L-185.

**4.** O sprovođenju ove odluke brinu: Predsednik Opštine i članovi komisije.

**5.** Nakon usvajanja  od strane Skupštine Opštine Kamenica, ova odluka stupa na snagu 30 dana nakon slanja nadzornom organuMALS-a i 7 dana nakon objavljivanja na službenoj opštinskoj stranici.

***Odluku slati**: Kancelariji Predsednika, Skupštinskoj Službi, Kancelariji Informisanja, Kancelariji Prevođenja, Članovima Komisije i GCUO-e – arhivi opštine.*

**Predsednik Opštine**

**Kadri Rahimaj**

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
QENDRA PËR SHËRBIM TË QYTETARËVE
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
Sh. 02 Nr. 22499
U. Br.
Nr. i faq. 02 Data: 18/08/2025
Br. str. Datum:
KAMENICË/A

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

**Juria për vlerësimin e punimeve për dizajnimin e stemës së Komunës së Kamenicës**

Në bazë të nenit 7 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/2008), nenit 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 3, paragrafëve 3.3, 3.4, 3.5 të Statutit të Komunës së Kamenicës Sh.01.Nr.20203 të datës 21.06.2023, Vendimit të Kuvendit Komunal të Kamenicës Sh.01.2669 të datës 03.02.2025 për formimin e Komisionit për inicimin e procedurave për ndryshimin e stemës së Komunës, Thirrjes Publike Sh.01.Nr.12435, të datës 22.05.2025, për hartimin dhe dizajnimin e stemës së re të Komunës së Kamenicës, Vendimit Sh.02 Nr.21513, i datës 08.08.2025 për formimin e jurisë për vlerësimin e punimeve për dizajnimin e stemës së Komunës së Kamenicës, Juria në mbledhjen e mbajtur më 14.08.2025, nxjerr këtë:

## R E K O M A N D I M

Juria e përbërë nga:

**1.1.** znj. Valdete Berisha Murina (Zyra e Informimit), kryesuese;
**1.2.** znj. Vjollcë Kryeziu (Drejtoria e Investimeve Kapitale), anëtare;
**1.3.** z. Sabit Zylfiu (Gjimnazi "Ismail Qemali" Kamenicë), anëtar;
**1.4.** z. Afrim Dërvishi (Drejtoria Komunale e Arsimit), anëtar; dhe
**1.5.** z. Ibrahim Beqiri, anëtar.

Pasi shqyrtoi të gjitha propozimet e dorëzuara, në përputhje me kriteret e Thirrjes Publike (kreativiteti, origjinaliteti, përfaqësimi i identitetit të Komunës, aplikueshmëria praktike dhe përputhshmëria me standardet vizuale institucionale), propozon për anulimin e përzgjedhjes së propozimeve sipas thirrjes.

## Arsyetim

Pas shqyrtimit të të gjitha propozimeve të pranuara sipas Thirrjes Publike Sh.01.Nr.12435, të datës 22.05.2025, për hartimin dhe dizajnimin e stemës së re të Komunës së Kamenicës,, juria konstatoi se shumica e tyre nuk i plotësonin në nivel të kënaqshëm kriteret e përcaktuara në thirrje. Mangësitë kryesore u evidentuan në këto drejtime:

1. **Mungesë e përfaqësimit gjithëpërfshirës**
   Shumica e dizajneve nuk arritën të reflektojnë në mënyrë të plotë dhe gjithëpërfshirëse elementet përfaqësuese të Komunës së Kamenicës. Aspektet kryesore të identitetit kulturor, historik dhe natyror nuk ishin të integruara në mënyrë të mjaftueshme.

2. **Mangësi në konceptim dhe strukturë**
   U evidentuan dobësi të theksuara në konceptimin artistik dhe në strukturën kompozicionale të propozimeve. Në disa raste, elementet ishin të mbingarkuara dhe humbnin qartësinë vizuale, ndërsa në raste të tjera ishin të mangëta për të përfaqësuar denjësisht komunën.

3. **Pamjaftueshmëri teknike dhe simbolike**
   Një pjesë e konsiderueshme e dizajneve nuk plotësonin standardet bazike teknike dhe simbolike të përcaktuara në udhëzimet e konkursit. Mungesa e përpunimit profesional dhe paaftësia për të krijuar një lidhje të drejtpërdrejtë midis simboleve dhe identitetit të komunës ishin ndër arsyet kryesore të mosmiratimit.

4. **Potencial i kufizuar për zhvillim të mëtejshëm**

Megjithëse disa propozime shfaqën elemente me potencial për përmirësim, ato kërkonin ndërhyrje të thella teknike dhe konceptuale për t'u përshtatur si simbol dhe logo zyrtare e Komunës së Kamenicës.

Për këto arsye, juria vlerësoi se asnjë nga propozimet e pranuara nuk përmbushte në tërësi standardet dhe kriteret e nevojshme për t'u pranuar si stemë e Komunës së Kamenicës. Si rrjedhojë, juria sugjeron që të zhvillohen thirrje të reja dhe dizajnet ekzistuese të përmirësohen më tej.
Ky rekomandim është miratuar unanimisht nga të gjithë anëtarët e Jurisë më datë: 14.08.2025.

***Vendimi i`u dërgohet:***

- *Zyrës së Kryetarit;*
- *Shërbimit të Kuvendit;*
- *Zyrës së Informimit; dhe*
- *Arkivit.*

**Kryesues i Komisionit**

REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – KOMUNA E KAMENICËS – OPŠTINA KAMENICA – 02 KRYETARI I KOMUNËS – PREDSEDNIK OPŠTINE

____________________

*******************

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
QENDRA PËR SHËRBIM TË QY
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
Nr. 01 U. Br. Nr. 225/3
Nr. i faq. Br. str. 04 Data: Datum: 18/08/2025

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

**DREJTORIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL**
**Komisioni për Korrje – Shirje.**

**Nr.** 172 **/ Data** 18. 08 **/ 2025.**
**Kamenicë.**

| | |
|---|---|
| **REFERENC-Ë:** | |
| **PËR / ZA / TO:** | - Kryetarin e Kuvendit - z. Liridon Kastrati; |
| **CC:** | |
| **PËRMES / PREKO / THROUGH:** | - Drejtorit të DBPZHR. Shpend Morina;<br>- QSHQË-ës; |
| **NGA / OD / FROM:** | - Komisioni për korrje – shirje;<br>- Kaltrina Kryeziu – Kryetare e komisionit; |
| **TEMA/SUBJEKAT / SUBJECT:** | **INFORMATA PËRFUNDIMTARE;**<br>**Përfundimi i procesit të Korrje – Shirjeve;** |

| **Nr. i Zyrës:**<br>**Br. Kancelarije:**<br>**Room No:** | **Lokacioni:**<br>**Lokacija:**<br>**Extencion :** | **Objekti i Komunës** | **Datë** | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Për aktivitetin / Za aktivnost / For action | | | | | |
| Për miratim / Za usvaja nje / For aprovao | | | | | |
| Për nënshkrim / Za potpis / For signature | | | | | |
| Për komente / Za komentare/For comments/ | | | | | |
| A mund të diskutojmë / Dali mazemo raspravljati / May ëe discues | | | | | |
| Vëmendja e juaj / Vasa paznja / Your attention | | | | | |
| Sipas diskutimit / Kako je raspravljeno / As discussed | | | | | |
| Siç është kërkuar / Kako je zatrazeno / As requested | | | | | |
| Shënim dhe përgjigje / Beleika i odgovor / Note ande retur | | | | | |
| Për infromimin tuaj / Za vasu informaciju / For your information | | | | X | |
| Afati / Rok / Deadline | | | | | |

**Me Respekt !**

## ➢ *Përfundimi i fushatës së Korrje – Shirjeve;*

- ***Informata përfundimtare e fushatës së Korrje – Shirjeve ( 3 );***

- Në Komunën e Kamenicës, procesi i korrje-shirjeve ka filluar më datë 05.07.2025, duke filluar me korrjen e parcelave të mbjella me kulturën e Elbit, pastaj më datë 09.07.2025 ka filluar edhe korrje – shirja e sipërfaqeve të mbjella me kulturën e Grurit.

- Më datë 11.07.2025 është bë hapja zyrtare e fushatës së korrje-shirjeve në komunën tonë dhe ka përfunduar procesi i korrje – shirjeve më datë 05.08.2025. Sipërfaqet për korrje për këtë vit kanë qenë me sa vijon : Grurë 1,500 ha., Elb 80 ha., Tërshërë 80 ha. dhe 50 ha. me Trotikal. Rendimentet për këtë vit kanë qenë shumë të mira, krahasuar me temperaturat e larta që kanë mbretëruar këtë vit dhe kemi pasur një thatësi tejet të lartë pas muajit të majit dhe mesatarja për ha. për këtë vit ka qenë me sa vijon: Te Gruri ka qenë rreth 4,000 kg./ ha. kurse te Elbi ka qenë 3,200 kg./ ha. dhe gjithë sipërfaqet e korrura me këto kultura i takojnë sektorit privat.

Gjatë procesit të Korrje-shirjeve këtë vit në komunën tonë, kanë qenë të përfshirë rreth 32 Autokombajna.

- Edhe këtë vit, sikurse viteve tjera Korrje-Shirjet janë zhvilluar dhe përcjellë në bazë të programit të Korrje-Shirjeve dhe planifikimit të hartuar nga DBPZHR., si dhe Rregullores Komunale për Korrje - Shirje.

- Në bazë të Rregullores Komunale, Kryetari i komunës ka caktuar komisionin për Korrje - Shirje me këtë përbërje:

1. Kaltrina Kryeziu, - Kryesues;
2. Bektesh Dërmaku, - Anëtarë;
3. Naser Vllasi, - Anëtarë;
4. Musa Ismajli, - Anëtarë;
5. Besnik Kovani, - Anëtarë;

- Komisioni ka filluar punën së pari në përgatitjen e dokumentacionit, ka bë kontrollimin teknikë të autokombajnave në teren dhe i ka pajisur me Procesverbal për plotësimin e kushteve minimale teknike, njoftimin mbi procedurat e Korrje - Shirjes , mbrojtjes nga zjarri.

- Gjatë tërë fazës së këtij procesi, komisioni për së afërmi e ka përcjellë fushatën e Korrje - Shirjeve, në teren si: për mos respektim të rendit, për shkelje të rregullores etj., prandaj i tërë procesi i Korrje – Shirjeve ka qenë në nivelin e duhur. Rëndësi të veçantë Komisioni i ka kushtuar mënyrës dhe cilësisë së korrjes, në mënyrë që humbjet e drithit të jenë sa më të vogla dhe ne si komision kemi bë disa vizita në teren për të parë mbarëvajtjen e korrje –shirjeve.

- Sa i përket fushatës së Korrje-Shirjeve në komunën tonë, këtë vit i tërë procesi ka përfunduar suksesshëm dhe nuk kemi pasur asnjë ankesë nga fermerët apo kombajnerët.

- ***Korrje - Shirjet / 2025***

- Komisioni i caktuar nga Kryetari i Komunës për çdo vit organizon hapjen zyrtare të fushatës së Korrje – shirjeve, daljen në teren për të përcjellë procesin e korrje- shirjeve, daljen në teren për të bë kontrollimin e auto kombajnave për fillimin e korrje-shirjeve në komunën tonë.

Ne po i paraqesim disa foto nga fushata e Korrje-shirjeve si më poshtë:

1. **Hapja zyrtare e procesit të korrje-shirjeve;**





2. Përcjellja e procesit të korrje-shirjeve nga komisioni në teren;






3. Kontrollimi teknik i autokombajnave në teren nga komisioni;





Përfundimi i Korrje-Shirjeve në K. e Kamenicës,

/2025.

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

01 225/8 04 18/08/2025

# ODELJENJE ZA POLJOPRIVREDU, ŠUMARSTVO I RURALNI RAZVOJ

**Komisija za Vršidbu - Žetvu.**

**Br.** 172 **/ Datum** 18.08 **/ 2025.**
**Kamenica.**

| | |
|---|---|
| **REFERENCA:** | |
| **PËR / ZA / TO:** | - Predsedavajućeg Skupštine g. Liridon Kastrati; |
| **CC:** | |
| **PËRMES / PREKO / THROUGH:** | - Direktoru OPŠRR, Shpend Morina<br>- GUCO-e; |
| **NGA / OD / FROM:** | - Komisije za vršidbu - žetvu;<br>- Kaltrina Kryeziu – Predsednica komisije; |
| **TEMA/SUBJEKAT / SUBJECT:** | **KONAČNE INFORMACIJE;**<br>**Završetak procesa Vršidbe - Žetve;** |

| Nr. i Zyrës:<br>Br. Kancelarije:<br>Room No: | Lokacioni:<br>Lokacija:<br>Extencion : | Opštinski objekat | Datum | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Për aktivitetin / Za aktivnost / For action | | | | | |
| Për miratim / Za usvaja nje / For aprovao | | | | | |
| Për nënshkrim / Za potpis / For signature | | | | | |
| Për komente / Za komentare/For comments/ | | | | | |
| A mund të diskutojmë / Dali mazemo raspravljati / May ëe discues | | | | | |
| Vëmendja e juaj / Vasa paznja / Your attention | | | | | |
| Sipas diskutimit / Kako je raspravljeno / As discussed | | | | | |
| Siç është kërkuar / Kako je zatrazeno / As requested | | | | | |
| Shënim dhe përgjigje / Beleika i odgovor / Note ande retur | | | | | |
| Për infromimin tuaj / Za vasu informaciju / For your information | | | | X | |
| Afati / Rok / Deadline | | | | | |

**S poštovanjem !**

## ➢ *Završetak kampanje Vršidbe - Žetve;*

- ***Konačne informacije kampanje Vršidbe - Žetve ( 3 );***

- U Opštini Kamenica, proces vršidbe – žetve počeo 05.07.2025, počev žetvom zasejanih parcela sa kulturom Ječma, onda 09.07.2025 počela i vršidba – žetva zasejanih površina sa Pšenicom.

- Dana 11.07.2025 službeno je u našoj opštini otvorena kampanja vršidbe – žetve i proces vršidbe – žetve se završio 05.08.2025. Površine za žetvu za ovu godinu su bile sledeće: Pšenica 1,500 ha., Ječam 80 ha., Ovas 80 ha. i 50 ha. Trotikal. Prinosi za ovu godinu su bili veoma dobri, u poređenju sa visokim temperaturama koje su prevladale, i ove godine po završetku maja meseca je bila jako visoka suša. Prosek po ha za ovu godinu je sledeći: kod Pšenice prinos bio oko 4,000 kg./ ha. dok Ječam bio 3,200 kg./ ha. i sve ove požnjejene površine sa ovim kulturama pripadaju privatnom sektoru.

Tokom procesa Vršidbe – žetve ove godine u našoj opštini angažovano je 32 Autokombajna.

- I ove godine, kao i prethodnih godina Vršidba-Žetva je sprovedena i praćena na osnovu Programa Vršidbe – Žetve, izrađenog Plana od strane OPŠRR, kao i na osnovu Opštinskog pravilnika za Vršidbu-Žetvu.

- Na osnovu Opštinskog pravilnika, Predsednik opštine odredio komisiju za Vršidbu-Žetvu u sledećem sastavu:

1. Kaltrina Kryeziu, - Predsedavajući;
2. Bektesh Dërmaku, - Član;
3. Naser Vllasi, - Član;
4. Musa Ismajli, - Član; i
5. Besnik Kovani, - Član;

- Komisija svoj rad počela prvo pripremom dokumentacije, izvršila tehnički pregled autokombajna na terenu i opremala Zapisnikom za ispunjavanje minimalnih tehničkih uslova, obaveštenjem o postupcima Vršidbe – Žetve, zaštite od požara itd.

- Sve vreme faze ovog procesa, komisija je neposredno pratila kampanju Vršidbe – Žetve na terenu, kao: nepoštovavje reda, kršenje propisa itd., stoga proces Vršidbe – Žetve bio na zadovoljavajućem nivou.

- Poseban značaj Komisija posvetila načinu i kvalitetu vršidbe-žetve, kako bi gubici žitarice bili što manji te mi kao komisija smo napravili posete na terenu da bi neposredno se uverili na tok vršidbe - žetve.

- Što se tiče kampanje Vršidbe – Žetve u našoj opštini, ove godine sav proces uspešno završen i od poljoprivrednika ili kombajnera nismo imali nijednu žalbu.

- ***Vršidba-Žetva / 2025***

- Komisija određena od strane Predsednika Opštine svake godine organizuje službeno otvaranje kampanje Vršidbe – žetve, izlaskom na terenu da bi pratila proces vršidbe-žetve, izlaskom na teren da bi izvršila pregled autokombajna za početak vršidbe – žetve u našoj opštini.

U Nastavku predstavljamo nekoliko fotografija sa kampanje Vršidbe – žetve:

1. **Svečano otvaranje procesa vršidbe-žetve;**





2. Praćenje procesa vršidbe – žetve od strane komisije na terenu;






3. Tehnička kontrola autokombajna na terenu od strane komisije;





**Završetak Vršidbe-Žetve u Opštini Kamenica**
**2025 godina**

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
QENDRA PËR SHËRBIM TË QYTETARËVE
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
Sh. U. 02 Nr. Br. 22896
Nr. i faq. 2 Data: Datum: 21/08
KAMENICË/A 2025

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

**Zyra e Kryetarit**
**Sh.02.nr.307 dt. 21.08.2025**

Bazuar në nenet 11, 13, 17 shkronja f), 40 dhe 58 shkronja h) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare Nr. 28, publikuar më 4 qershor 2008); Udhëzimi Administrativ nr. 03/2009 për mënyrën e përfaqësimit të komunave në bordet e drejtorëve të ndërmarrjeve publike lokale, neni 2, paragrafi 2.1 dhe 2.3 të Ligjit Nr.03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, neni 17, paragrafi 1 të Ligjit Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, mbështetur në pikën 3 të Vendimit Sh.01.Nr.11289, të datës 11.04.2024, të Kuvendit Komunal në Kamenicë për emërimin e anëtarëve të Komisionit Komunal të Aksionarëve në PPP "ECOHIGJIENA" për pjesën publike të KRM "HIGJENA" në Gjilan; si dhe në nenin 5, paragrafi 5.1 shkronja f), nenin 38 paragrafi 38.1, nenin 70 paragrafi 70.1 shkronja h) dhe nenin 82 të Statutit Sh.01.Nr.20203, të datës 21.06.2023, të Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komunës, për mbledhjen e rregullt të Kuvendit të Komunës së Kamenicës që mbahet më _________ 2025, sjell këtë:

## PROPOZIM – V E N D I M
## PËR CAKTIMIN E LARTËSISË SË KOMPENSIMIT MUJOR PËR ANËTARËT E KOMISIONIT KOMUNAL TË AKSIONARËVE NË PPP "ECOHIGJIENA", PËR PJESËN PUBLIKE TË KRM "HIGJENA" NË GJILAN

1. Me këtë vendim caktohet lartësia e kompensimit mujor për anëtarët e Komisionit Komunal të Aksionarëve në PPP "ECOHIGJIENA", për pjesën publike të KRM "HIGJENA" në Gjilan.

2. Shuma e kompensimit të rregullt mujor për secilin anëtar të Komisionit Komunal të Aksionarëve në PPP "ECOHIGJIENA", për pjesën publike të KRM "HIGJENA" në Gjilan, caktohet në lartësi prej 200,00 € (dyqind euro), si dhe plus 50,00 € (pesëdhjetë euro) për çdo takim të mbajtur, por jo më shumë se katër takime brenda vitit.

3. Pagesa do të realizohet prej ditës kur ky vendim hyn në fuqi. Me vendim të veçantë do të bëhet pagesa për muajt të cilët nuk janë paguar, e më pas do të vazhdojë të realizohet në baza mujore për secilin anëtar, për aq kohë sa ai/ajo është pjesë aktive e Komisionit Komunal të Aksionarëve në PPP "Ecohigjiena" (për pjesën publike të KRM "Higjiena").

4. Mjetet për kompensimin e anëtarëve të Komisionit Komunal të Aksionarëve ndahen nga Buxheti i Komunës, nga kodi buxhetor i pagave dhe mëditjeve.

5. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës, përmes Drejtorisë për Buxhet dhe Financa.

6. Bashkëngjitur këtij Vendimi është Vendimi Sh.02.Nr.11289, të dates 11.04.2024, i Kuvendit Komunal për emërimin e anëtarëve të Komisionit Komunal të Aksionarëve në PPP "ECOHIGJIENA" për pjesën publike të KRM "HIGJENA" në Gjilan.

7. Ky vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

***Arsyetim***

Duke marrë parasysh se Vendimi Sh.01.Nr.11289, i datës 11.04.2024, i Kuvendit Komunal për emërimin e anëtarëve të Komisionit Komunal të Aksionarëve në PPP "ECOHIGJIENA", për pjesën publike të KRM "HIGJENA" në Gjilan, që prej hyrjes në fuqi nuk ka përcaktuar asnjë lartësi kompensimi për anëtarët e Komisionit, dhe për pasojë ata kanë mbetur pa kompensim për periudhën që kanë ushtruar funksionin;

Në zbatim të Vendimit të Kuvendit Komunal Sh.01.Nr.11289, të datës 11.04.2024, me këtë vendim përcaktohet lejimi i kompensimit të anëtarëve të Komisionit, duke garantuar kompensimin retroaktiv dhe vazhdimësinë e pagesave sipas afateve mujore, konform dispozitave ligjore dhe akteve nënligjore në fuqi.

***Vendimi i`u dërgohet:***

- ***Zyrës së Kryetarit;***
- ***Shërbimit të Kuvendit;***
- ***Zyrës së Përkthimeve;***
- ***Anëtarëve të Komisionit; dhe***
- ***Arkivit.***

**Kryetari i Komunës**

**Kadri Rahimaj**

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
QENDRA PËR SHËRBIM TË QYTETARËVE
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
Sh. U. 02 Nr. Br. 23061
Nr. i faq. Br. str. 2 Data: Datum: 22/08
KAMENICË/A 2025

**Zyra e Kryetarit**
**Sh.02.Nr.308, datë:22.08.2025**

Bazuar në nenin 5 shkronja b), neni 11, neni 12 paragrafët 1 dhe 2 shkronja d), neni 17 dhe neni 58 shkronja h) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale; neni 53 paragrafët 1 dhe 3 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 20/21, Qershor 2016); neni 12 paragrafi 2 të Rregullores (MAPL) Nr. 02/2021 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimit të Akteve të Komunës; Vendimi Sh.01.Nr.17378, i datës 10.07.2025 i Kuvendit Komunal në Kamenicë për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit shumëfunksional në shërbim të komunitetit lokal në fshatin Muçivërc, si dhe neni 3 paragrafi 3.7, neni 5 paragrafi 5.1 shkronja h), neni 38 dhe neni 70 paragrafi 70.1 shkronja h) të Statutit Sh.02.Nr.20203 të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komunës, për mbledhjen e rregullt të Kuvendit të Komunës së Kamenicës që mbahet më ________ 2025, sjell këtë:

# PROPOZIM VENDIM

**Për ndryshimin e Vendimit Bazë Sh.01.Nr.17378, të datës 10.07.2025, për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit shumëfunksional në shërbim të komunitetit lokal në fshatin Muçivërc**

1. Ndryshohet paragrafi (2) i Vendimit Bazë Sh.01.Nr.17378, datë 10.07.2025, për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit shumëfunksional në shërbim të komunitetit lokal në fshatin Muçivërc, dhe riformulohet si vijon:

2. Në paragrafin (2), në vend të ngastrës kadastrale P-71107055-00707-1, me sipërfaqe prej 25.163 m², ndryshohet dhe plotësohet me ngastrën kadastrale P-71107055-00707-4, me sipërfaqe prej 2.156 m². Pjesa tjetër e Vendimit Bazë mbetet e pandryshuar.

3. Ky Vendim është pjesë përbërëse e Vendimit Sh.01. Nr. 17378, datë 10.07.2025, për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit shumëfunksional në shërbim të komunitetit lokal në fshatin Muçivërc.

4. Bashkëngjitur këtij Vendimi është Vendimi Sh.01.Nr.17378, datë 10.07.2025, për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit shumëfunksional në shërbim të komunitetit lokal në fshatin Muçivërc, Kopja e Planit e datës 03.07.2025, Ekstrakti nga Certifikata, dhe Letër Informata Sh.02.16598, e datës 03.07.2025 e lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor.

5. Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Kamenicës, ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës – MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të internetit të Komunës.

***Arsyetim***

Me datë 10.07.2025, Kuvendi i Komunës ka miratuar Vendimin Bazë Sh.01. Nr. 17378 për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit shumëfunksional në shërbim të komunitetit lokal në fshatin Muçivërc.

Më pas, me datë 06.08.2025, nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) është pranuar Vlerësimi i Ligjshmërisë me nr. prot. 5376-2/25, përmes së cilit Vendimi i Kuvendit është kthyer në rishqyrtim.

Gjatë procedurës është konstatuar se, për shkak të nenparcelizimit të ngastrave kadastrale, në Vendimin Bazë ishte përfshirë gabimisht parcela kadastrale P-71107055-00707-1 (me sipërfaqe prej 25.163 m²), e cila është e destinuar për hapësirë shkollore.

Lokacioni i saktë për ndërtimin e objektit shumëfunksional caktohet në parcelën ngjitur me numër kadastral P-71107055-00707-4, me sipërfaqe prej 2.156 m², Sipas Leter-informatës së Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, kjo parcelë është e planifikuar për ndërtim, në përputhje me planet urbanistike.

Ky ndryshim bëhet për të korrigjuar pasaktësinë teknike të vendimit fillestar dhe për të siguruar përputhshmëri me legjislacionin dhe destinimin e tokës sipas planeve urbanistike.

***Vendimi i`u dërgohet:***

- ***Zyrës së Kryetarit;***
- ***Zyrës së Informimit;***
- ***Zyrës së Përkthimeve;***
- ***Drejtorisë për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi;***
- ***Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor; dhe***
- ***Arikivit.***

**Kryetari i Komunës**

**Kadri Rahimaj**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
Njësia org. / Org.Jedinica / Org.Unit: 02
Nr.i Prot. / Broj Prot. / Prot. No.: 5376-2/25
Nr.i Faqeve / Br.Stranica / No.Pages: -02-
Data / Datum / Date: 06.08.25
PRISHTINË / A No.1

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**
**Qeveria - Vlada – Government**

***Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës***
***Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture***
***Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure***

| | | |
|---|---|---|
| Për: | Kadri Rahimaj, Kryetar i Komunës së Kamenicës<br>Liridon Kastrati, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Kamenicës | |
| Kopje: | Elbert Krasniqi, Ministër në Detyrë në MAPL<br><br>Jeton Qela Sekretar i Përgjithshëm në MAPL<br>Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL | |
| Përmes: | Liburn Aliu, Ministër në Detyrë në MMPHI<br><br>Izedin Bytyqi, U.D Sekretar i Përgjithshëm në MMPHI | |
| Nga: | Florije Kika, Drejtore e Departamentit Ligjor | Nr. 135/25<br>Datë: 16.07.2025 |
| Zyrtarët përgjegjës:<br>1.Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor<br>2.Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor | Shendrita Latifi – Zyrtare e Lartë Ligjore në Divizionin për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Legjislacionit dhe Mbështetjes Ligjore | |
| Lënda: | Vlerësimi i ligjshmërisë së aktit komunal | |
| Lloji i aktit: | Vendimi 01 Nr. 17378 për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit shumë funksional në shërbim të komunitetit lokal në fshatin Muçivërc, miratuar nga Kuvendi Komunal i Kamenicës, datë 30.06.2025 | |

I nderuar kryetar Rahimaj,
I nderuar kryesues Kastrati

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), në pajtim me nenin 9 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe Rregullores (QRK) Nr.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (QRK) Nr.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, me datë 11.07.2025 ka pranuar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), Vendimin 01 Nr. 17378 për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit shumë funksional në shërbim të komunitetit lokal në fshatin Muçivërc, miratuar nga Kuvendi Komunal i Kamenicës, datë 30.06.2025.

MMPHI pas shqyrtimit të ligjshmërisë së aktit në fjalë, dhe në pajtim me nenin 8, 9 dhe 10 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave kërkon nga Kuvendi Komunal i Kamenicës:

**RISHQYRTIMIN E LIGJSHMËRISË SË AKTIT**

Vendimi 01 Nr. 17378 për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit shumë funksional në shërbim të komunitetit lokal në fshatin Muçivërc, miratuar nga Kuvendi Komunal i Kamenicës, datë 30.06.2025.

**ARSYETIMI**

MMPHI pas shqyrtimit të vendimit të lartcekur konstatoi se:

Në preambulë, ky vendim bazohet në Ligjin Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, për të cilin ligj nuk kemi kompetencë.

Sa i përket destinimit të parcelës, sipas dokumentacionit të bashkëngjitur në Letër Informatë datë 07.07.2025 nga Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, parcela në fjalë, bazuar në dokumentin e planifikimit hapësinor në fuqi, është paraparë për Hapësirë Shkollore. Gjithashtu, Plani Zhvillimor Komunal i miratuar këtë vit nga Komuna, e përcakton po ashtu këtë shfrytëzim.

Inkurajojmë Komunën e Kamenicës që të fillojë sa më parë procesin e hartimit të Hartës Zhvillimore Komunale (HZK), sipas parashikimeve ligjore në fuqi, në mënyrë që shfrytëzimet e tilla të përfshihen dhe të jenë të qarta në dokumentet përkatëse.

Njëkohësisht, bazuar në Rregulloren e Qeverisë së Republikës Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, dhe Shtojcën: Lista e akteve të komunës që nuk i nënshtrohen shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë, ky vendim mund të përfshihet në kuadër të kësaj liste.

Nga ajo që u tha më lartë, të veprohet sipas vlerësimit të ligjshmërisë së aktit komunal nga MMPHI, të merret vendim i drejtë dhe i ligjshëm në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, jo më vonë se afati i paraparë në dispozitat e Ligjit Nr. 08/ L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe Rregulloren (QRK) Nr.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (QRK) Nr.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave.

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE
Njësia org. / Org Jedinica / Org Unit: 11-01
Nr. i Prot. / Broj Prot. / Prot. No. 5496-2/25
Nr. i Faqeve / Br. Stranica / No. Pages: -03-
Data / Datum / Date: 20.08.25
PRISHTINË / A

# Republika e Kosovës

## Republika Kosova - Republic of Kosovo

*Qeveria – Vlada - Government*

*Ministria e Mjedisit , Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës*
*Ministarstvo Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture*
*Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

***Kabineti i Ministritit / Kabinet Ministra / Kabinet of the Minister***

| | |
|---|---|
| DATË/A: | 15.08.2025 |
| REFERENC-Ë: | 25/5496/MMPHI |
| PËR/ZA/TO: | Komunat: Gjilan, Ferizaj, Kaçanik, Viti, Hani i Elezit, Kamenicë, Shtime dhe Novobërdë |
| CC: | |
| PËRMES/PREKO/THROUGH: | |
| NGA/OD/FROM: | Liburn Aliu , Ministër në detyrë i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT: | Vendim |

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, ka pranuar kërkesën nga Gjilan, Ferizaj, Kaçanik, Viti, Hani i Elezit, Kamenicë, Shtime dhe Novobërdë, me nr.: 25/5496/425/DMM, dhe pas shqyrtimit të bërë ka vendosur sikurse në vendimin e bashkangjitur kësaj letërpërcjellëse.

1. Vendimi për Pëlqim Mjedisor për Raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor (VSM) për Planin Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave (PNMIM), për komunat e rajonit të Gjilanit dhe Ferizajt

Me respekt,



Adresa: Objekti i Ri Qeveritar, ish Pallati i Mediave " Rilindja" kati 17, nr: 1713 - 10 000 Prishtinë - Kosovë
Telefon: + 381 38-200-32-307
http://www.ks-gov.net/mmphi, E-mail: zsp.mmphi@ks-gov.net

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
***Qeveria – Vlada - Government***

*Ministria e Mjedisit , Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës*
*Ministarstvo Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture*
*Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

***Kabineti i Ministrit / Kabinet Ministra / Kabinet of the Minister***

Ministri i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, duke u bazuar në nenin 93 paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 10 të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratën Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare, Nr.7, 01 Mars 2019), nenin 11 paragrafi 1, nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare, Nr.34/22 dt. 18.11.2022), Shtojcën 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr.14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive si dhe nenit 13 të Ligjit për Vlerësim Strategjik Mjedisor Nr. 03/L-230 (Gazeta Zyrtare Nr. 83/29 tetor 2010 ), nxjerr:

## VENDIM

**APROVOHET** kërkesa e Komunave: Gjilan, Ferizaj, Kaçanik, Viti, Hani i Elezit, Kamenicë, Shtime dhe Novobërdë për paisje me **Pëlqim Mjedisor** për Vlerësimin Strategjik Mjedisor për Planin Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave (PNMIM), për komunat e rajonit të Gjilanit dhe Ferizajt.



Adresa: Objekti i Ri Qeveritar, ish Pallati i Mediave " Rilindja" kati 17, nr: 1713 - 10 000 Prishtinë - Kosovë
Telefon: + 381 38-200-32-307
http://www.ks-gov.net/mmphi, E-mail: zsp.mmphi@ks-gov.net

**A r s y e t i m**

Gjatë shqyrtimit të kërkesës së Komunave: Gjilan, Ferizaj, Kaçanik, Viti, Hani i Elezit, Kamenicë, Shtime dhe Novobërd, Komisioni për shqyrtimin e Raporteve të VSM-së i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës ka konstatuar se Komunat: Gjilan, Ferizaj, Kaçanik, Viti, Hani i Elezit, Kamenicë, Shtime dhe Novobërdë kanë ofruar të gjitha dokumentet e parapara me Ligjin Nr. 03/L-230 për Vlerësim Mjedisor si dhe i ka përmbushur të gjitha obligimet tjera ligjore përfshirë organizimin e debateve publike, publikimin e Raporteve të VSM-së në ueb faqen e Komunave për komente dhe trajtimin e komenteve të marura nga palët e interesit.

**Këshilla Juridike**: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicoj konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të të njejtit.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Nr.: 25/5496/ /24 datë: 15.08.2025

Prishtinë

z. Liburn Aliu

Ministër në detyrë i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

T'i dërgohet:

1. *Parashtruesit të kërkesës*
2. *Komisionit për VSM*
3. *Inspektoratit të MMPHI-së*
4. *Zyrës të Sekretarit të Përgjithshëm*
5. *Kabinetit të Ministrit*
6. *Arkivi i MMPHI*
7. *Divizionit për komunikim me publikun*
8. *Komunave: Gjilan, Ferizaj, Kaçanik, Viti, Hani i Elezit, Kamenicë, Shtime dhe Novobërdë*



Adresa: Objekti i Ri Qeveritar, ish Pallati i Mediave " Rilindja" kati 17, nr: 1713 - 10 000 Prishtinë - Kosovë
Telefon: + 381 38-200-32-307
http://www.ks-gov.net/mmphi, E-mail: zsp.mmphi@ks-gov.net